

VENDIM
Nr.30, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datën 9.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti që u përket :

KËRKUES:

1. PARTIA BASHKIMI DEMOKRISTIAN, e përfaqësuar nga avokat Nik Progni.
2. PARTIA SOCIALISTE, e përfaqësuar nga Z.Bashkim Caka.
3. PARTIA DEMOKRISTIANE, në mungesë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 5.7.1997, i cili ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës elektorale nr.2, lidhur me rezultatin përfundimtar të votimit të datës 29 qershor 1997.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuessve, subjektin e interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Duke marrë parasysh se objekti dhe shkaku i kërkesave të paraqitura nga subjektet elektorale është i njëjtë, Gjykata Kushtetuese vendosi t'i bashkojë ato në një gjykim të vetëm.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin datë 5.7.1997 ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.2, që i përket rrethit të Malësisë së Madhe, i cili ka shpallur fitues kandidatin për deputet të Partisë Demokratike.

Palët në kërkesat e tyre dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë pretenduar se disa qendra votimi janë caktuar në lokale private, se nga shumica e zgjedhësve nuk është kryer votimi, se në edicionet e lajmeve të mjeteve të informimit publik është njoftuar se zgjedhjet në zonën 2 do të shtyhen, se janë regjistruar zgjedhës më shumë se sa kanë qenë në të vërtetë në atë zonë, se janë falsifikuar firmat e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e qendrave të votimit, si dhe janë larguar nga komisionet e zgjedhjeve zëvendëskryatrët e këtyre komisioneve.

Në kundërshtim me pretendimet e sipërme, u provua se caktimi i disa qendrave të votimit në lokale private është vendosur nga organet kompetente të pushtetit lokal për shkaqe objektive dhe kjo nuk vjen në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", pasi nuk ndalon caktimin e qendrave të votimit edhe në lokale private.

Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendohet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka marrë vendim për shtyrjen e zgjedhjeve të zonës nr.2 dhe as Radiotelevizioni Shqiptar në edicionet e lajmeve të datës 29.6.1997 nuk ka njoftuar shtyrjen e zgjedhjeve në këtë zonë. Përkundrazi, zgjedhjet janë zhvilluar me një pjesëmarrje të gjerë të votuesve. Sipas procesverbaleve të qendrave të votimit rezulton se në zgjedhje ka marrë pjesë mbi 70 % e votuesve të kësaj zone.

Përsa i përket pretendimit se janë regjistruar më shumë zgjedhës se kanë qenë në të vërtetë në

atë zonë dhe se janë falsifikuar firmat e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e qendrave të votimit, kërkesit nuk paraqitën prova për vërtetimin e tij.

Është e vërtetë se në 22 qendra votimi, procesverbalet e komisionit të qendrës së votimit nuk janë firmosur nga zëvendëskryetarët e këtyre komisioneve, por kjo nuk mund t'i bëjë ato të pavlefshme, mbasi sikurse pasqyrohet në disa nga këto procesverbale, ata janë larguar vetë nga detyra, pa shkaqe të motivuara.

Duke u nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesat janë të pabazuara dhe si të tilla duhen rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24, pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet e mëvonshme, me shumicë votash

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 19.7.1997